

20110170390

L I GJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM VULLNETAR
PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2008 dhe 124/10) në nenin 4 pika 21 ndryshohet si vijon:

"Reputacion të mirë" ka personi i cili posedon kompetence, punë dhe karakteristika tjera të cilat japin siguri se me mënyrën e punës së tij nuk do ta rrezikojë stabilitetin dhe sigurinë e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale dhe nuk do t'i rrezikojë interesat e anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe të mos ketë dëshmi për përfshirjen e tij paraprakisht në aktivitete afariste që nënkuptojnë mosrespektim të rregullave, praktikave dhe procedurave afariste;"

Në pikën 22. nënpika a) ndryshohet si vijon:

"a)në pesë vitet e fundit:

- nuk ka pasur interes material ose marrëdhënie afariste me shoqërinë si partner afarist ose si person udhëheqës, anetar i këshillit drejtues ose anëtar i këshillit mbikëqyrës në partnerin afarist të shoqërisë ose

- nuk ka qenë i punësuar, nuk është anëtar i këshillit drejtues ose anëtar i këshillit mbikëqyrës i shoqërisë;"

Në pikën 23, pas fjalës "informatë" presja dhe fjalët: "para lëshimit, distribuimit ose shpalljes së tij në mjetet për informim publik" shlyhen.

Neni 2

Në nenin 28 paragrafi (10) shlyhet.

Paragrafi (11) bëhet paragraf (10).

Neni 3

Në nenin 61 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Për marrjen e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni dhe lejes së kushtëzuar për menaxhim me fondin pensional vullnetar si dhe për regjistrimin e fondit pensional vullnetar në regjistrin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, dorëzon në Agjenci:

a) kërkesa me dokumentacion të theksuar në nenet 38 dhe 39 paragrafi (1) pikat a), b), v), zh), x), j), k) dhe ll) të këtij ligji;

b) deklaratë të nënshkruar nga nënshkruesit e autorizuar të shoqërisë se nëse merr leje do të bëjë ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe do të themeloje fond pensional vullnetar në pajtim me këtë ligj dhe

v) plan afarist i cili i përmban detaje për të gjitha kompensimet dhe provizionet që do të arkëtohen në pajtim me këtë ligj."

Neni 4

Në nenin 67 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Për marrjen e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni dhe lejes së kushtëzuar për menaxhim me fondin pensional të detyrueshem si dhe për regjistrim të fondit të detyrueshem në regjistrin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, shoqëria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare, dorëzon në Agjenci:

a) kërkesa me dokumentacion të theksuar në nenet 54 dhe 55 paragrafi (1) pikat a), b), v), zh), x), j), k) dhe ll) të këtij ligji;

b) dokumente me të cilat vërtetohet se në datën e paraqitjes së kërkesave themeluesit e shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare, që do të posedojnë 51% nga kapitali themelues i shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, kanë përvojë të madhe në menaxhimin me mjete;

v) deklaratë të nënshkruar nga nënshkruesit e autorizuar të shoqërisë se nëse merr leje për kryerjen e veprimtarisë - menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme, do të beje ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise dhe do të themelojë fond pensional të detyrueshëm në pajtim me këtë ligj dhe

g) plan afarist i cili i përmban detajet për të gjitha kompensimet dhe provizionet të cilat do të arkëtohen në pajtim me këtë ligj."

Neni 5

Ne nenin 86 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale pushon me:

a) shuarjen e marrëdhënies së punës ose anëtarësisë në shoqatën e qytetarëve dhe bartjen e mjeteve nga llogaria profesionale ekzistuese në llogari tjetër profesionale ose llogari individuale vullnetare, në pajtim me këtë ligj dhe

b) heqjen e skemës pensionale profesionale dhe bartjen e mjeteve nga llogaria profesionale ekzistuese në llogari tjetër profesionale ose llogari individuale vullnetare në pajtim me këtë ligj."

Neni 6

Neni 92 ndryshohet si vijon:

"(1) Mjetet e pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale, të cilit i ka pushuar marrëdhënia e punës ose anëtare-sia te një sigurues barten nga llogaria profesionale ekzistuese në llogarinë e ardhshme profesionale të skemës pensionale profesionale e organizuar nga siguruesi tjetër.

(2) Nese pas kalimit të 90 ditëve nga pushimi i marrëdhënies së punës ose anëtarësisë në shoqatën e qytetarëve, personi nuk bëhet pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale te sigurues tjetër, mjetet nga llogaria e tij profesionale ekzistuese barten në llogarinë e tij individuale vullnetare.

(3) Nese mjetet nga llogaria profesionale nuk barten në llogarinë e tij individuale vullnetare pas kalimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, shoqëria e cila e udhëheq llogarinë profesionale ekzistuese do të kërkojë informatë nga Agjencia, nëse anëtari ka llogari individuale vullnetare dhe nese ka i bart mjetet nga llogaria profesionale ekzistuese në llogarinë individuale vullnetare.

(4) Nese shoqëria merr informatë nga Agjencia se anëtari nuk ka llogari individuale vullnetare, ajo i hap llogari individuale vullnetare në fondin pensional vullnetar me të cilin menaxhon dhe i bart mjetet nga llogaria profesionale ekzistuese në llogarinë individuale vullnetare. Njëkohësisht shoqëria anëtarit i dorëzon vërtetim për anëtarësim.

(5) Nese siguruesi e ndërprente skemën pensionale profesionale, mjetet e pjesëmarrësit të skemës pensionale profesionale barten në pajtim me dispozitat e paragrafëve (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(6) Agjencia e përcakton kohën dhe mënyrën e bartjes së mjeteve në pajtim me paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni."

Neni 7

Në nenin 94 në paragrafët (1) dhe (3) numri "18" zëvendësohet me numrin „15“.

Neni 8

Ne nenin 107 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Shoqëria e cila menaxhon me fondin pensional vull-netar detyrohet që ta dorëzojë në Agjenci, në fotokopje ose në medium të jashtëm përkatës, materialin e publikuar për marketing

në afat prej tri ditësh pas publikimit të tij. Agjencia miraton udhëzime për përmbajtjen e reklamave dhe për materialin tjetër për marketing të fondeve pensionale vullnetare dhe të shoqërive të cilat menaxhojnë me to."

Në paragrafin (5) fjalët: "ose ta prolongojë publikimin e tij" zëvendësohet me fjalët: "publikimin e mëtejshëm".

Neni 9

Neni 108 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqeria mund të kryejë punë marketingu të fondit pensional vullnetar në lokalet e tij dhe në lokalet e bashkepunetoreve të tij afaristë për marketing. Lokali duhet t'i plotesoje kushtet në vijim:

a) të ketë së paku një agjent;

b) të ketë person përgjegjës për kryerjen e punëve të marketingut të shoqërisë i cili menaxhon me fond pensional vullnetar, që mund të jetë i punësuar në bashkëpunëtorin afarist dhe

v) të sigurojë lokal përkatës për kryerjen e punëve të marketingut të shoqërisë e cila menaxhon me fond pensional vullnetar.

(2) Bashkepunetor afarist për marketing nga paragrafi (1) i këtij neni mund të jetë banka ose shoqëria për sigurim.

(3) Shoqeria është përgjegjëse për plotësimin e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Shoqeria në ditën e fundit të punës së tremujorit, dorezon në Agjenci listë të lokaleve të bashkëpunëtorëve afariste për marketing, e cila përveç emrit i përmban edhe adresen dhe personin përgjegjës."

Neni 10

Në nenin 112 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Ndalohet që personi përgjegjës të punësuarit t'i reklamojë fond pensional vullnetar, përveç në rast kur punedhenesi ka organizuar skemë pensionale profesionale për të punësuarit e tij."

Neni 11

Në nenin 131 paragrafi (1) pika e) ndryshohet si vijon:

"e) obligacione të emetuara në bazë të miratimit nga Komisioni për Letra me Vlerë i Republikës së Maqedonisë dhe të cilat kuotojnë në tregun zyrtar të bursës së letrave afatgjate me vlerë ose në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë të cilin e kontrollon Komisioni, të emetuara nga njësitë e vetadministrimit lokal dhe nga shoqëri aksionare të vendit që nuk janë banka;"

Neni 12

Në nenin 132 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Mjetet e fondit pensional vullnetar mund të investohen në letra me vlerë të emetuesit të njëjtit më së shumti deri 10% nga vlera nominale e letrës së veçantë me vlerë të emetuar nga emetuesi. Me përjashtim, në obligacione dhe letra tjera me vlerë të emetuara nga njësitë e vetadministrimit lokal dhe nga shoqëritë aksionare të vendit mund të investohen më së shumti deri në 20% nga vlera nominale e letrës së veçantë me vlerë të emetuara nga emetuesit. Mjetet e fondit pensional vullnetar nuk mund të investohen në më shumë se 40% nga obligacionet e përgjithshme të emetuara të njësisë së vetadministrimit lokal. Në obligacionet dhe letrat tjera me vlerë të emetuara ose për të cilat garanton Republika e Maqedonisë ose ndonjë prej shteteve anetare të BE-së ose të OECD-së mund të investohet pa kufizim."

Në paragrafin (2) shtohet fjali e re si vijon:

"Me përjashtim, në pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese të emetuara nga shoqëria e njëjtë për menaxhim nga shteti-anëtar i BE-së ose OECD-së, mund të investohen më së shumti 15% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar, me ç'rast në fondin e veçantë investues mund të investohen më së shumti 5% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar."

Në paragrafin (3) përqindja "7,5%" zëvendësohet me përqindje „15%“.

Neni 13

Në nenin 133 pika g) pikëpresja zëvendësohet me pikë dhe shtohet fjali e re si vijon: "Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 10% nga vlera e mjeteve të fondit pensional vullnetar, mund të investohen në obligacione të emetuara nga njësitë e vetadministrimit lokal."

Neni 14

Në nenin 147 pas fjalës "ligj" pika shlyhet dhe shtohen fjalet: "me të cilin rregullohet pagesa e pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me financim kapital".

Neni 15

Pas nenit 164 shtohet nen i ri 164-a si vijon:

"Neni 164-a

Procedura për sugjerim dhe edukim

(1) Nese gjatë kryerjes së kontrollit personi i autorizuar për kontroll konstaton se për herë të parë është bërë parregullsi nga nenet 34 paragrafët (3), (4) dhe (5), 107 paragrafi (4), 109 paragrafi (8) dhe 116 të këtij ligji, detyrohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta konstatojë parregullsine e bërë me sugjerim për mënjanimin e parregullsise së konstatuar në afat prej 15 ditësh nga sugjerimi dhe me dergim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia.

(2) Formen dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe menyren e realizimit të edukimit e përcakton Agjencia.

(3) Edukimin e organizon dhe e realizon Agjencia, në afat prej jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së kontrollit.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të njëjta ose të njëllojta të konstatuara për një ose më shumë subjekte.

(5) Nese në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nese personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e konstatuar.

(7) Nese personi i autorizuar për kontroll gjatë kryerjes së kontrollit konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërprente procedurën e kontrollit.

(8) Nese personi i autorizuar për kontroll gjatë ushtrimit të kontrollit konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqet kerkese për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në Komisionin për Vendimmarrje për Kundërvajtje.

(9) Agjencia mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia."

Neni 16

Në nenin 166 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri 7-a), si vijon:

"7-a) nëse lokalet e shoqërisë dhe lokalet e bashkëpunetoreve të saj afaristë për marketing, nuk i plotësojnë kushtet nga neni 108 paragrafi (1) i këtij ligji;"

Neni 17

Në nenin 167-a paragrafi (1) pika 3 ndryshohet si vijon:

„nese nuk e dorëzon në Agjenci, në fotokopje ose në medium të jashtëm përkatës, materialin e publikuar për marketing në afat prej tri ditësh pas publikimit të tij.”

Neni 18

Deri në miratimin e ligjit me të cilin rregullohet pagesa e pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me financim kapital, pagesa e kompensimit pensional do të kryhet me pagesë të njëhershme të shumës së përgjithshme nga llogaria e anëtarit.

Neni 19

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 20

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që të përcaktojë tekst të spastruat të Ligjit për sigurim vullnetar pensional me financim kapital.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.